

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Debati te Ligjet/ Ulsi Manja i fik mikrofonin kreut të Unionit të Gjyqtarëve: Jemi ne sovrani
ADRESA	https://piranjat.al/politike/debati-te-ligjet-ulsi-manja-i-fik-mikrofonin-kreut-te-union-it-te-gjyqta-i104247
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 14:52:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 14:51:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c22f2b5aa865ccb02da13fe5a7cb37090dfdc943cdc56fe2701d914353e6630a
TEKSTI	74aed68aa9a2c1b0775b24ed1de066d12a3fcfab942aba7897ba99eacf204910
PAMJA	36183d154a3349d58492ccaa11b8870a0ac61eadd1a0e9070971d17fbc6dfc8b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	80d7ac121662c4cfac41f4c1461fd21134c2bd4bfaf1174f4d413fa70b66a3b4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/80d7ac121662c4cfac41f4c1461fd21134c2bd4bfaf1174f4d413fa70b66a3b4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **me lehtësira fiskale** Demokratike kërkon nga qeveria që të... **benet aktori me filmat më** karrierën e tij, duke u ngjitur në krye të listës... **ekstradimin e Ervin Matës** Shqipërisë për ekstradimin e Ervin... **me baktere për turistët AKU** qëndrimi në ambientet... **shperblen trajnerin Luis de** nënshkrimi të kontrarës së re me...

[POLITIKE](#)

Debati te Ligjet/ Ulsi Manja i fik mikrofonin kreut të Unionit të Gjyqtarëve: Jemi ne sovрани

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 16:51



Një debat i tensionuar është zhvilluar sot në Komisionin e Ligjeve mes kryetarit të tij, Ulsi Manja, dhe kreut të Unionit të Gjyqtarëve të, Gerd Hoxha. Përplasja nisi pasi Hoxha kërkoj të shprehte qëndrimin e Unionit edhe për vendimin e Gjykatës Kushtetuese, mbi pagat e gjyqtarëve, ndërsa Manja e orientoi të fokusohet te projektligji që po shqyrtohej.

Debati u përshkallëzua me replika, deri në momentin kur Manja urdhëroi fikjen e mikrofonit të Hoxhës, duke i thënë: “Ky është Kuvendi i Shqipërisë dhe është sovрани”.

Pjesë nga debati:

Manja: Zoti Hoxha e ka fjalën, për të dhënë edhe ai, në emër të Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, qëndrimin në lidhje me, të bëjmë një saktësim, me projektligjin, jo me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, vendimi i saj e ka thënë çfarë ka për të thënë vetë, ne duam një qëndrim tuajin me projektligjin që diskutuam sot.

Hoxha: Tani nëse na keni thirrur këtu, do na respektoni dhe do ta dëgjoni çfarë do të themi.

Manja: Jo jo, ju thoni çfarë të doni...

Hoxha: Në qoftë se do të më orientosh se si do diskutoj, më vjen keq, por nuk është kjo. Ne iu respektuam të gjithëve ju, ftesa erdhi 15 minuta përpara, nuk ishte aspak serioze, por për të respektuar Kuvendin, popullin shqiptar, magistratët dhe Kushtetuesen, ne erdhëm sot këtu për të dhënë mendimet tona. Se çfarë do të diskutojmë ne, brenda kuadrit ligjor, atë e dimë ne, kështu që do t'iu lutesha të na dëgjoni. Do flasim për vendimin e Kushtetuese, ku është zanafilla. Nuk mund të shkojmë të flasim për degët, kur kemi prerë pemën. Nëse e pret pemën, degët bien në tokë, kështu që, ju lutem, na lini të flasim.

Manja: Zoti Hoxha, t'i ndajmë gjërat, ky është Kuvendi i Shqipërisë dhe është sovрани.

Hoxha: Po patjetër!

Manja: Ne kemi shumë respekt për pushtetin që ju përfaqësoni.

Hoxha: Na respektoni se na keni ftuar si miq.

Manja: Të lutem, të lutem, fikeni mikrofonin, nuk regjistron. Ne kemi shumë respekt për ju. Edhe nuk ua kufizojmë të drejtat, shumë faleminderit që keni ardhur, do iu dëgjojmë me shumë vëmendje, fol çfarë të duash, shpreh opinionin në emër të Unionit të Gjyqtarëve, por jo me këtë gjuhë me sovranin, të lutem.

Hoxha: Gjuha ishte me shumë edukatë, në të njëjtin intonacion si ju...

Manja: Shiko, ju nuk mund të interpretoni fjalët e mija, unë kam gjatë durimin sot, edhe si kryetar komisioni, por edhe kolegët e mijë deputet, t'iu dëgjojmë deri në fund. Ju jepni opinionin tuaj se unë nuk orientoj çfarë do të thoni. Unë sot ju kam thirrur për projektligjin, për këtë ishte ndërhyrja ime, ju mund të thoni çfarë të doni, kështu që merrni fjalën, keni të gjithë kohën në dispozicion.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 15 Shtator 16:41

[Debate për pagat e gjyqtarëve në komisione, Bardhi: S'mund t'i trajtojmë me lëmoshë gjyqtarët](#)

Draft i paraqitur nga Partia Socialiste për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve ka hasur me kundërshtimin e opozitës dhe të institut...

POLITIKE 15 Shtator15:40

[Pagat e magjistratëve/ Zv.kryetari i GJL kundër formulës së PS: Nuk e realizon standardin e vendosur nga Kushtetuesja](#)

Zv.kryetari i Gjykatës së Lartë, Ilir Panda, ka kundërshtuar në Komisionin e Ligjeve formulën e propozuar për pagat e magjist...

POLITIKE 15 Shtator15:27

[Vendimi i Gjykatës së Lartë për Veliajn, reagon Rama: Askush s’po do t’ia dijë për koston përditë të të parit kryeqytet në botë](#)

Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas vendimit të Gjykatës së Lartë për të lënë në fuqi masën e arrestit në...

POLITIKE 15 Shtator15:21

[Bozdo “zbërthen” skemën korruptive: Ron Yeffet erdhi “me duar në xhepa”, qindra miliona euro kalojnë pa asnjë kontroll](#)

Deputeti i Partisë Demokratike, Enno Bozdo ka denoncuar publikisht atë që e quajti një skemë të mirëmenduar korupsioni dhe p...

POLITIKE 15 Shtator15:12

[Strategjia e re amerikane për Ballkanin: Shqipëria përballë sfidës së karteleve dhe krimit të organizuar](#)

Zëvendës Ndihmës Sekretari i Shtetit, Daniel Lawton, do të paraqesë sot përpara Nënkomitetit për Evropën në Ko...

POLITIKE 15 Shtator14:47

[“S’ju pje*dh njeri”, Korreshi përplasjet me Gogun për Sokol Sadushin: I lidhni shallin sa herë ka mbledhje me...](#)

Ndërsa Korreshi fliste për gjyqtarët me tone të ashpra, ministri Gogu iu drejtua duke i thënë se deputeti i PD ende nuk e ka kup...

POLITIKE 15 Shtator12:22

[Gjykata e Lartë la Veliajn në burg/ Tabaku: Rama bashkëpërgjegjës për korrupsionin në Tiranë](#)

Deputetja demokrate Jorida Tabaku ka reaguar pas vendimit të Gjykatës së Lartë për vijimin e masës së sigurisë “...

POLITIKE 15 Shtator09:54

[Konflikti për pagat e magjistratëve, BIRN: Një kapitull i ri i përplasjeve të Ramës me drejtësinë! Qëllim shpërqendrimi nga protestat](#)

Konflikti për pagat e magjistratëve u shndërrua në një përplasje të re publike mes kryeministrit Edi Rama dhe drejtësi...

POLITIKE 15 Shtator07:43

[Dita e 108-të e protestës, kërkohet dorëheqja e Ramës dhe qeverisë së tij!](#)

Protesta qytetare në Tiranë vijon edhe sot, duke shënuar ditën e 108-të të tubimeve të njëpasnjëshme. Protestuesi...

POLITIKE 14 Shtator22:52

[Hetimet e SPAK/ Tomorri: Temperatura ka ndryshuar! Balluku s’është më e fuqishme si më parë](#)

Gazetari i ekonomisë Klodian Tomorri e cilësoi çështjen e Belinda Ballukut si një nga hetimet me peshën më të madhe fi...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

[FOTO- ‘Mos u kthe më në Shqipëri’/ Edi Rama sul...](#)

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

[EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl...](#)

Një shtetas shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

BOTA 14 Shtator


[“E drog*va dhe abuz*va gruan për 20 vite”/ Bash...](#)

Një burrë britanik pranoi sot se kishte droguar dhe përdhunuar gruan e tij në shtëpinë e tyre për rreth dy dekada. Burri, ban...


Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video




Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.